

BIBLIOTEKA

165

12 92

KOLI XOXI



ERASMI ROTERDAM

DHE

HELENA GJIKA

2

KOLI XOXI

ERASMI ROTERDAM
DHE
HELENA GJIKA

BIBLIOTEKA E
BASHKIS GJIROKASTEB
NB INV

54352

SHTËPIA BOTUESE "MARIN BARLETTI"
TIRANË 1994

punoi në kompjuter Arjan Muça

tirazhi 1 000 kopje

© të drejtat e botimit i rezervohen autorit

PARATHENIE

Njohja me kulturën përparimtare të Evropës Perparimtare ka qenë një nga tiparet më me vlerë të përfaqësuesve më të shquar të popullit shqiptar. Ky kontinent, sidomos pas zbulimeve të mëdha gjeografike, ka qenë për tyre si djepi i qyteterimit botëror të ri. Ky shprehëj, pas atij greko-romak, nepermjet Humanizmit të Rilindjes dhe më në fund, nepermjet Iluminizmit, si trashëgimtar i denjë i tyre.

Humanizmi evropian ka qenë fillimi i një periudhe të re në historinë e zhvillimit të mendimit shkencor të Evropës Perëndimore. Ideali për një dinjitet më të vërtetë njerëzor, fryma kritike kundër dogmës dhe skolastikës, vetëdija historike në shpjegimin e botës që na rrethon, puna vetmohuese për të njohur gjithçka reale, sado e fshehur që të dukej, për të kuptuar e interpretuar universin, por edhe ç'përfaqëson kombi, të gjitha këto përbenin një botëkuptim krejt të ndryshëm nga ai mesjetar. Referimi qyteterimit të lashtë lindor, dhe të atij greko-romak sidomos, përbente një mbështetje të fortë për këtë zhvillim të ri të kulturës njerëzore. Për Erasmin kulturë e lashtë mund të ndihmonte fare mirë në njohjen sa më të hollësishme të kulturës së krishterë.

Një nga humanistët më të mëdhenj, ose më mirë kryetari i tyre shpirtëror, me një horizont jashtëzakonisht të gjerë e të thellë shkencor e kulturor, për kohën kur jetoi e punoi, ka qenë edhe Desideri Erasmi i Roterdamit, jetën dhe botëkuptimin e të cilit autori i këtyre radhëve është përpjekur ta japë në këtë botim.

Për humanizmin dituria nuk ishte një suditje e thjeshtë, por një veprim i vazhdueshëm, një burim i pashtershëm që nuk ta shuan atënjëherë.

Me erudicionin e tij të gjerë e kritiken e hollë, me zotërimin e gjuhëve antike, Erasmi u bë figura më përfaqësuese e kulturës së Rilindjes evropiane në gjysmën e parë të shekullit XVI. Për të kultura është pasuri e mirëfilltë e njeriut: ajo fitohet me punë këmbëngulëse, është e lidhur me atë që e përvetëson, duke u thelluar në të gjithmonë e më shumë. Ajo nuk e largon kurrë njeriun nga virtyti, përkundrazi, ia forcon atë gjithmonë e më shumë, duke pasuruar shpirtin njerëzor. Nga një kulturë e thellë dhe e gjithanshme njeriu ndien kënaqësinë më të madhe: sa më shumë merr prej saj, aq më tepër kërkon; me kulturën njeriu është gjithçka, pa të mbetet një qenie e varfër. Kultura humaniste, ishte një zbulim i dinjitetit njerëzor, i panjohur tërësisht deri atëherë. Ajo i dha goditjen e fundit edukatës skolastike e fanatike kishtare dhe shpalli fuqishëm se fare mirë mund të ketë edhe kulturë laike të lashtë.

Të gjitha kërkesat e dëshirat njerëzore janë trajtuar në veprat e këtij humanisti të madh holandez me burrëri e ndershmëri por edhe me humor, e, pse jo edhe me një dell të fuqishëm demokratik për të drejtat e njeriut, që përbën pasurinë më fisnike të personaliteteve historike të të gjithë kohëve. Ata iu përkushtuan NJERIUT pa të cilin jeta e vërtetë nuk kishte kuptim.

Në këtë botim lexuesi ka për të vënë re se ka edhe përsëritje, të cilat edhe mund të shmangeshin, por mendojmë se ato janë të domosdoshme për të freskuar kujtesën herë pas here, madje kryesisht për ato çështje që kanë preokupuar më shumë botën e atëhershme. Kështu, megjithëse Erasmi ka jetuar shekuj më parë, gjithçka që ai trajton në veprat e tij madhore është në rendin e ditës edhe sot. Siç duket, plagët e kësaj bote janë aq të rënda sa që shërohen me ngadalësi, me gjithë sakrificat e mendimtarëve viganë.

Sipas Erasmit, filozofët e mëdhenj paganë grekë e romakë, si dhe vetë Krishti pas tyre, vlenin shumë për veprën e madhe që kishin lënë, për shembujt e lartë që kishin dhënë në jetë e që duhen imituar. Feja e mirëfilltë ka për detyrë t'i shërbejë jetës morale, përndryshe roli i saj është i papërfillshëm. Dhe Erasimi si i krishterë, sheh te Krishti personifikimin e virtytit më të lartë. Kjo ishte arsyeja që ai dëshironte që

filozofia e Krishtit të përhapej jo vetëm në njerëzit e qytetëruar ,por në të gjithë popullin, gra e fëmijë. Dhe virtyti i kultivuar në masën e popullit transformon shpirtin njerëzor.

Një kapitull i është kushtuar edhe Helena Gjikkës, merita e madhe e së cilës është se me mendjen e saj fisnike ka prekur po ato plagë, herëherë shumë lënduese. Kështu që studimi i veprës së saj e radhit atë në vargun e iluministëve të shquar. Mendoj se në këtë vështrim ajo njihet tepër pak në Shqipëri.

Por duke i dhënë lexuesit këtë botim, na ka shkuar mendja edhe tek vepra e shkrimtarit francez Marsel Prust “mbi të lexuarit”, në të cilën autori arrin në përfundimin se leximi nuk është asgjë tjetër veçse një bisedë me autorët e mëdhenj.

Punimi është shoqëruar edhe me një bibliografi të shkurtër.

A U T O R I

HUMANISTI I MADH DESIDERI ERASMI ROTERDAMI (1469-1536)

Lëvizja humaniste në mesjetë ka karakter të theksuar shoqëror, kulturor dhe politik. Ajo mund të përcaktohet edhe si ideologji, që megjithëse nuk shpreh një filozofi të caktuar, e drejton tehun kundër skolasikës feudale në shëmbje e sipër. Përfaqësuesit më kryesorë të humanizmit në mesjetë janë në Gjermani, gjuhëtari Joan Reinklin (1455-1522), piktori Albreht Dyrer (1471-1528), Filip Melanhtoni (1497-1560), Ulrich fon Hutten (1488-1523), i përmëndur për sulmet e tij kundër oborrit papal mesjetar dhe për veprën "Letrat për njerëzit e errët" në prag të Reformës së Luterit; piktori Holbein i Vjetri (1465-1524), piktori Holbein i Ri (1497-1543), i biri i të parit në Itali; Jakopo de Barbari (1440-1566), Leonardo da Vinçi (1452-1519), filozofi Piko dela Mirandola (1463-1494); në Spanjë, filozofi Huan Luis Viv (1493-1540); në Angli, autori i veprës "Utopia" Tomas Mor (1478-1535), për të cilin Erasmi do të shkruante: "Burri shumë i dëgjuar në Angli"; në Francë, shkrimtari Fransua Rabele (1494-1553), shkrimtari Mishel Montenj (1533-1592), e të tjerë, por që për qëllimin që i kemi vënë vetes u mjaftuam me kaq. Por lexuesi është në dijeni se ka edhe humanistë shqiptarë që kanë vepruar në Europën Perëndimore, ndër të cilët Marin Barleti është më kryesori. Në Europë, njëri nga më të mëdhenjtë, ka qënë Desiderius Erasmus, hollandes nga Roterdami, mbrojtës i Krishterimit kritik, dijetar i pashtershëm, i cili e shpalli veten "qytetar të botës" pavarësisht nga kombësia, me parullën: "Dikur lumi Rin i ndante galët nga gjermanët, por lumi Rin nuk mund të ndajë të krishterin nga i krishteri" Tërë jetën ai i bëri thirrje vullnetit të mirë të të gjithëve që të mbeten gjithnjë të bashkuar duke bërë lëshime reciproke. Ai, pothuaj si gjithë të tjerët, ka shkruar në

latinishte, gjuha e kulturës në atë kohë. Këtë gjuhë praktikonin teologët, juristët, mjekët, farmacistët, nëpunësit e lartë të oborreve, mbretërore, këshilltarët e oborreve madje edhe shumë mjeshër të shoqërive esnafore e tregëtare. Kishte familje në të cilat bisedonin me njëri - tjetrin latinisht, edhe me fëmijët; latinishtja ishte gjuha e kishës katolike, e qelive të shumta apo të kuvëndeve të murgjve, e shkrimtarëve, filozofeve, studiusve. Pra ajo që dukej si gjuhë e vdekur, në të vërtetë ishte tepër e gjallë, pavarësisht nga dëmet që mund t' u sillte gjuhëve kombëtare që po lindnin.

Si emri dhe mbiemri i tij, Desidersiu latinisht dhe Erasmi greqisht, në shqip mund të përkthehen "I ëmbli". Kjo nuk do të thotë se ai, si temperament, ishte gjithmonë i tillë, sidomos në polemikat kundër njërezve të errësirës, po për lexuesin e veprës së tij është me të vërtetë i ëmbël.

Njeriu i ri, për Erasmin, ishte pohim i një rilindjeje të re në krahasim me shoqërinë e kaluar. Erasmi është njeriu që përfaqësonte të vërtetën e pastër, e cila mirëpritej prej bartësve të përparimit. Atë e dëgjonin të gjithë ata që nuk pajtoheshin me rutinën shekullore dhe dëshironin të shikonin shoqërinë të zhveshur nga padituria, paragjykimet mesjetare, fanatizmi dhe egoizmi, nga të gjitha veset, të cilat, për Erasmin e Roterdamit, burimin e kishin tek injoranca. Besimtar i vërtetë për të është ai që punon, njeriu modest e jo kryelartë, zemërgjerë e jo meskin. Satirës së tij nuk i shpëtonin mbretët, papët, princat, tregtarët, murgjit dhe gjithë suita e tyre, prandaj edhe ndaj tij u drejtua urrejtja dhe mëria e tyre.

Erasmi e njihte mirë rolin e mëparshëm të kuvëndeve dhe të murgjve. Në fillim në ato institucione puna për murgun ishte më se e domosdoshme, sepse ajo i shërbente zotit. Perandoria e vonshme romake e përbuste punën dhe njeriu i pasur e quante të ligjshëm dëfrimin për të, po kështu edhe pushtuesit e asaj perandorie. Vetëm luftën qanin mision të tyre. Kurse kisha e hershme e krishtere, vetë apostulli Pavël kishte shpallur se ai që nuk punon nuk ha, prandaj puna e njeriut filloi të pranohej si diçka e shenjtë. "Me djersën tënde do ta hash bukën, deri sa të kthehesh në dheun prej nga mbive", thuhet në Dhjatën e Vjetër.

Murgu kishte detyrë të merrej edhe me lexime për të ushqyer shpirtin e vet; të krijonte bibliotekën dhe arkiva dokumentare. Dhe në të vërtetë

shumë kuvende apo manastire qenë kthyer në depo të kulturës së lashtë. Dhe në fakt për studiuesin e atëhershëm s'kishte vend më të mirë e më të qetë se Kuvendi, për shkak se aty kishte një bibliotekë. Por në kohën e Erasmit kuvendet qenë kthyer në qendra shthurjeje dhe, sipas humanistit tonë, nga kjo gjendje e mjeruar ata duhej medoemos të delnin. Për njerëz të shturur apostulli Pavël kishte thënë : “Perëndia për ta ishte krimbi; fundi i tyre është vdekja” Për gjendjen e manastireve në periudhën e Erasmit mund të shprehemi me fjalët e Dantes: “S’ka më të madh hidhërim se sa të kujtosh kohën e bardhë në mjerim”.

S’ka dyshim se për humanistët shkencat e natyrës kishin shumë rëndësi për formimin e njeriut, por ato shoqërore zinin vendin e parë, sepse nëpërmjet përvetësimit të tyre njeriu, si kafshë shoqërore, kthehej në njeri të vertetë. Këtë mësim humanistët e kishin nxjerë nga kultura e lashtë greko-romake, së cilës i qenë përkushtuar, por jo vetëm prej saj.

Humanisti italian Piko dela Mirandola shkruante: “Kam lexuar në librat e arabëve se në botë nuk ka asgjë më të mrekullueshme se njeriu”. Këtu e ka fjalën për njeriun e kulturuar në mënyrë të gjithanshme. Nëse ky përvetëson edhe shkencat natyrore, ose të sakta, aq më mirë. Sipas tyre, ky lloj njeriu do të ishte dyfish i vyer si përmbysës i së vjetrës dhe i ndërtimit të një bote njerëzore të re. Vetëm si i tillë ai do ta ndjejë veten të lumtur sepse është i lirë gjatë jetës së tij kalimtare mbi tokën. Humanistët pra ishin njerëzit e horizonteve të gjera e që shihnin larg.

Shëndetlig por me forcë të madhe shpirtërore, Erasmi që tërë jetën vuajti nga ethet, cerma, litiiza urinare, lindi në Deventer, pranë Roterdamit, në Vendet e Ulta. I ati, që e kishte quajtur Gerhardus Gerhardi (biri i Gerhardt), sipas emrit të vet, ishte nga Guda. I dashuruar me vajzën e një mjeku, Margaritën, pa bërë kurorizimin zyrtar, sepse nuk lejohej për arsye se ishin me fe të ndryshme, lindi një fëmijë, Erasmin e ardhshëm. Por me që në Guda nuk ishte lehtë të rrisje një fëmijë, u vendos për pak kohë në Romë, ku punoi si kopist. Me të ardhurat e pakta mbante fëmijën dhe nënën e saj . Por dashuria për Margaritën vazhdonte e fortë tek ai, prandaj ishte i vendosur të kthehej dhe të bashkohej me të. Në Romë u dorëzua dhe u kthye në vendlindje.

Mësimet e para i bëri në vendlindje, ku si mësues shquhej Aleksandër Hegius. Në vitet 80-të të shekullit të 15-të shkolla ku ky mësues jepte mësim ishte një nga vatrave e para të humanizmit në Vendet e Ulta. Mësimet mbi krishterimin që u mësoheshin këtu nxënësve ishin të çliuruara nga ngarkesat e tepërta dhe nga mënyra skolastike e të mësuarit. Pikërisht në këtë shkollë Erasmi zbulon një botë të re, atë të studimeve, që mbeti pasioni i vetëm në gjithë jetën e tij.

Sëmundja e murtajës shumë e përhapur në atë kohë në Europën Perëndimore, korpte pa kursim jetë njerëzish; ajo rrëmbeu edhe Margaritën. Dëshpërimi e mbërtheu të shoqin, të cilin e ndoqi fati i bashkëshortes, duke e lënë fëmijën shtatëmbëdhjetë vjeç. Murtaja u përhap për herë të parë në Europë në vitin 1348 nga vendet e Lindjes nëpërmjet tregtarëve dhe thuhet se në rreth tre vjet rrëmbeu një të tretën e popullsisë

Mjedisi shoqëror e shqetësonte Erasmin. Prej natyre me zgjuarsi të rrallë, djali i ri e zëvendësoi emrin e mëparshëm me Desiderius (latinisht) ose Erasmi (greqisht). Me këtë emër të ri ai u bë i dëgjuar nëpërmjet veprave të tij.

Në periullën mesjetare, në Europën Perëndimore kishte shumë murgj. Murg u bë edhe Erasmi, por, siç shkruan një autor, ai ishte “xhelati i punës”. Truri i tij nuk e ndërpreu kurrë studimin, mendja e tij stërmundimin. Ai nuk bëri kurrë gjumë të thellë, siç ndoll në tërë atë që truri nuk i lë kurrë të qetë. Ai nuk u shkëput nga njohuritë e reja, pa të cilat e mbërthente mërzia, të cilën ai e konsideronte armike të egër të punës studimore. Kërusja e shpinës mbi libra mbeti tek ai si një nga kënaqësitë e tij më të thella. Pa një kënaqësi të tillë e vështirë se do të arrinte të 67 vjetët dhe se do të bëhej një nga dijetarët më të mëdhenj të kohës së tij. Ai hante tepër pak. Për këtë ai do të shkruante me ironi se kishte kokën e një katoliku dhe stomakun e një protestanti.

Më 25 qershor 1492, me ndihmën e peshkopit të qytetit verior të Francës Kambre, Henrikut të Bergenit, u dorëzua prift. Në këtë qytet qëndroi si sekretar i tij pesë vjet, pastaj ndoqi studimet në Paris, në Kolegjin Montegy, ku në ato kohë të zymta, për shkak të papastërtive të shumta,